



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

RAPORT
I
AVOKATIT TË POPULLIT

Ex officio nr. 695/2022

Lidhur me arsimimin dhe aftësimin gjithëpërfshirës të personave me aftësi të kufizuara për qasjen në tregun e punës

Për:

Znj. Arbërie Nagavci, ministre
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Z. Hekuran Murati, ministër
Ministria e Punës, Financave dhe Transfereve
Z. Bashkim Ramosaj, kryetar, Komuna e Deçanit
Z. Bexhet Xheladini, kryetar, Komuna e Dragashit
Z. Burim Berisha, kryetar, Komuna e Fushë Kosovës
Z. Agim Aliu, kryetar, Komuna e Ferizajt
Znj. Ljiljana Shubariq, kryetare, Komuna e Graçanicës
Z. Mehmet Ballazhi, kryetar, Komuna e Hanit të Elezit
Z. Ilir Ferati, kryetar, Komuna e Istogut
Z. Besim Ilazi, kryetar, Komuna e Kaçanikut
Z. Kadri Rahimaj, kryetar, Komuna e Kamenicës
Z. Zenun Elezaj, kryetar, Komuna e Klinës
Z. Vladan Bogdanoviq, kryetar, Komuna e Klllokotit
Z. Imri Ahmeti, kryetar, Komuna e Lipjanit
Z. Ekrem Kastrati, kryetar, Komuna e Malishevës
Z. Abdylhadi Krasniç, kryetar, Komuna e Mamushës

Z. Bedri Hamza, kryetar, Komuna e Mitrovicës së Jugut
Z. Sasha Milosheviq, kryetar, Komuna e Novobërdës
Z. Xhafer Gashi, kryetar, Komuna e Obiliqit
Z. Dragan Petkoviq, kryetar, Komuna e Parteshit
Z. Gazmend Muhaxheri, kryetar, Komuna e Pejës
Z. Shpejtim Bulliqi, kryetar, Komuna e Podujevës
Z. Përparim Rama, kryetar, Komuna e Prishtinës
Z. Shaqir Totaj, kryetar, Komuna e Prizrenit
Z. Smajl Latifi, kryetar, Komuna e Rahovecit
Znj. Katarina Ristiq-Iliq, kryetare, Komuna e Ranillugut
Z. Dalibor Jevtiq, kryetar, Komuna e Shtërpçës
Z. Qemajl Aliu, kryetar, Komuna e Shtimes
Z. Fadil Nura, kryetar, Komuna e Skenderajt
Z. Bali Muharremaj, kryetar, Komuna e Therrandës
Z. Sokol Haliti, kryetar, Komuna e Vitisë
Z. Ferit Idrizi, kryetar, Komuna e Vushtrisë
Z. Erden Atiq, kryetar, Komuna e Mitrovicës së Veriut
Z. Izmir Zeqiri, kryetar, Komuna e Zubin Potokut
Z. Ilir Peci, kryetar, Komuna e Zveçanit
Z. Lulzim Hetemi, kryetar, Komuna e Leposaviqit
Z. Ramiz Lladrovci, kryetar, Komuna e Glllogocit
Z. Ardian Gjini, kryetar, Komuna e Gjakovës
z. Ruzhdi Shehu, kryetar, Komuna e Junikut
Z. Alban Hyseni, kryetar, Komuna e Gjilanit

Kopje:

Habit Hajredini, drejtor

Zyra e Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë

Prishtinë, më 27 maj 2025

QËLLIMI I RAPORTIT

Raporti ka për qëllim vlerësimin e situatës së arsimimit dhe të aftësimit gjithpërfshirës të personave me aftësi të kufizuara, për qasje dhe konkurrim në tregun e punës. Përmes analizës së mundësive dhe vështirësive të cilat personat me aftësi të kufizuara i hasin, raporti synon që të vlerësojë sistemin arsimor për përgatitjen e tyre që të jenë të pavarur për t'iu qasur tregut të punës, në pajtim me dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore për të drejtat e fëmijës në arsim dhe për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Raporti përmban rekomandime për përmirësimin e politikave dhe praktikave të institucioneve të arsimit të lartë dhe të arsimit profesional për t'i zgjeruar mundësitë për zhvillim personal dhe ekonomik më të suksesshëm të personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës.

KOMPETENCAT E AVOKATIT TË POPULLIT

1. Avokati i Popullit, sipas Kushtetutës dhe sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit¹ (në tekstin e mëtejme: Ligji për Avokatin e Popullit), pos të tjerash, i ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike (neni 132, paragrafi 1, i Kushtetutës);
- Avokati i Popullit mund të japë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe të lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore (neni 135, paragrafi 3, i Kushtetutës);
- të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, i Ligjit për Avokatin e Popullit);
- t'i rekomandojë Qeverisë, Kuvendit dhe autoriteteve të tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jodiskriminimit (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, i Ligjit për Avokatin e Popullit);
- t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, i Ligjit për Avokatin e Popullit).

KORNIZA LIGJORE

2. Kushtetuta e Republikës së Kosovës mbron dhe siguron të drejtat themelore të njeriut, përfshirë të drejtat e fëmijëve, dhe në nenin 22 përcakton se të drejtat dhe liritë e garantuara me marrëveshjet ndërkombëtare zbatohen drejtpërdrejt në vend dhe kanë prioritet mbi ligjet dhe aktet publike. Në kontekstin e arsimit, Kushtetuta, veçanërisht në nenin 47, përcakton se çdo person ka të drejtën për arsim themelor pa pagesë, me qëllim të zhvillimit të potencialit njerëzor dhe të përgjigjes ndaj nevojave të veçanta. Dispozitat theksojnë rëndësinë e arsimit gjithpërfshirës, mundësive të barabarta dhe përmbushjes së nevojave specifike të çdo fëmije, duke reflektuar vlerat kushtetuese dhe qëllimet për zhvillim.

¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10922>

3. Në veçanti paragrafi i dytë i nenit 47, përtej ofrimit të arsimit, thekson nevojën për t'i ofruar çdo individ një arsim cilësor që përmbush "*aftësinë dhe nevojat specifike*" të tij, si të drejta të patjetërsueshme dhe të pacenueshme në bazë të rendit juridik të Republikës së Kosovës. Kjo dispozitë përcakton përgjegjësi shtesë për autoritetet shtetërore për llojin e arsimit që duhet t'u ofrohet të gjithë fëmijëve dhe të rinjve të Republikës së Kosovës. Në përgjithësi, Kushtetuta në nenin 47 ngërthen tri obligime themelore: (1) Sistemi arsimor duhet të ofrojë qasje në arsim, përfshirë arsimin themelor të detyrueshëm; (2) arsimi duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe duhet të ofrojë mundësi të barabarta për arsimim; (3) arsimimi duhet të shërbejë për përmbushjen e nevojave themelore dhe specifike të çdo fëmije.²
4. Ngjashëm shtetet obligohen sipas nenit 28 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës (KDF), që të sigurojnë arsim fillor, i cili është detyrues dhe pa pagesë për të gjithë fëmijët, inkurajojnë zhvillimin e arsimit të mesëm në forma të ndryshme, ndihmojnë për arritjen e arsimit të lartë sipas aftësive të secilit dhe promovojnë praninë dhe angazhimin e rregullt shkollor.³
5. E drejta në arsim përcaktohet edhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) - në Protokollin shtesë nr.11, ku në nenin 2 të saj përcaktohet: "*Askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për arsimim. Shteti, në ushtrimin e funksioneve që merr përsipër në fushën e edukimit dhe të arsimit, respekton të drejtën e prindërve për të siguruar këtë edukim dhe arsim në përputhje me bindjet e tyre fetare dhe filozofike.*" Këto konventa vlerësojnë se arsimimi është faktor kryesor i zhvillimit të qëndrueshëm të njeriut, përmes të cilit rritet përmirësimi i cilësisë së jetës në nivel individual, familjar, shoqëror dhe global.⁴
6. Për më tepër, Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK) si instrument kryesor ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, detyron shtetet ta njohin të drejtën e tyre për arsimim pa diskriminim dhe në baza të barabarta, duke promovuar dhe mbrojtur këto të drejta. Kjo Konventë kërkon nga shtetet të ndërtojnë një sistem arsimor gjithëpërfshirës, që zhvillon potencialin njerëzor, aftësitë dhe pjesëmarrjen e tyre në shoqëri.⁵ Republika e Kosovës ende nuk e ka përfshirë KDPAK-në në kuadër të Kushtetutës, përkundër rekomandimeve të vazhdueshme të personave me aftësi të kufizuara në Kosovë, përfaqësuesve të tyre si dhe vetë Avokatit të Popullit, përgjatë viteve.
7. Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (LMF), si ligj kryesor në Kosovë për sa u përket fëmijëve, ka për qëllim të mbrojtë fëmijën nga çdo lloj dhune fizike dhe mendore, duke garantuar përgjegjësitë e prindërve, familjes, kujdestarëve, shoqërisë dhe shtetit për kujdesin, mbrojtjen dhe zhvillimin e tij sipas interesit më të mirë të fëmijës. LMF-ja në mënyrë specifike adreson të drejtat e fëmijës duke përfshirë dispozita të veçanta lidhur me arsimimin. Konkretisht neni 37, paragrafi 2, i LMF-së thekson: "*Ministria përkatëse për*

² Kushtetuta e Republikës së Kosovës - E drejta për Arsimin.

³ Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuata, Konventa për të Drejtat e Fëmijës 1989, në nenet 28 dhe 29, <https://www.unicef.org/montenegro/media/9291/file/MNE-media-MNEpublication505.pdf> Konventa është drejtpërdrejt e zbatueshme në Kosovë dhe ka përparësi zbatimi krahasuar me aktet e tjera ligjore vendore në bazë të nenit 22 të Kushtetutës.

⁴ E drejta për edukim garantohet me nenin 26 të DUDNJ-së.

⁵ Nenet 7, 24 dhe 26, Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Protokollin Opsional, në: https://www.un.org/disabilities/documents/convention/crpd_albanian.pdf.

arsim duhet të sigurojë qasje gjithëpërfshirëse dhe frekuentim të arsimimit falas e cilësor, në bazë të mundësive të barabarta dhe pa diskriminim, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tyre për të kuptuar në të gjitha nivelet e arsimit para universitar. Kjo e drejtë i garantohet edhe fëmijës që dëshiron të vazhdojë të arsimohet pas përfundimit të arsimit të detyrueshem.” Për më tepër, ky paragraf fokusohet në aftësinë e nxënësit, një referencë që duhet marrë parasysh gjatë planifikimit dhe organizimit të mësimi për fëmijët dhe për të rinjtë me aftësi të kufizuara. Pra, përmbajtja e kurrikulës duhet të përshtatet për t’i shërbyer më së miri arritjes së potencialit të këtyre nxënësve në bazë të aftësive të tyre.⁶ Po ashtu, në nenin 46 parashihet obligimi që fëmija me aftësi të kufizuara të përfitojë nga shërbimet edukative, si dhe çdo shërbim tjetër, sipas nevojave, të përcaktuara nga strukturat përgjegjëse të vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Institucionet përgjegjëse marrin masa që këto shërbime të ofrohen sa më pranë fëmijës dhe falas sa herë të jetë e mundur dhe duke pasur parasysh gjendjen ekonomike të prindit si dhe eliminojnë të gjitha barrierat infrastrukturore, sociale, mjedisore, institucionale dhe ligjore në fushat e arsimit, punësimit dhe arsimit profesional që fëmijët me aftësi të kufizuara t’i ushtrojnë të drejtat e parashikuara në këtë ligj.

8. Ligji për Arsimin Paruniversitar në Republikën e Kosovës (LAPRK) bazohet në parimet gjithëpërfshirëse dhe përkrah nxënësit me aftësi të kufizuara. Sipas tij, institucionet arsimore dhe aftësuese duhet t’i akomodojnë të gjithë fëmijët, pa dallim të kushteve të tyre fizike, intelektuale, sociale, gjuhësore apo të tjera dhe të promovojnë integrimin dhe kontaktin mes fëmijëve.⁷
9. Për më tepër, LAPRK-ja obligon ministrinë, komunat, institucionet arsimore dhe të gjitha organet e tjera, të përfshira në ofrimin e arsimit parauniversitar, që të planifikojnë dhe të ofrojnë shërbime efikase, efektive, fleksibile, gjithëpërfshirëse dhe profesionale, të dizajnuara për t’u ofruar të gjithë fëmijëve të drejtat e barabarta për shkollim, në pajtim me aftësitë dhe nevojat e tyre specifike, si dhe për të avancuar zhvillimin e tyre arsimor e social.⁸ Ndërsa, sipas neni 5, ministria u përcakton modalitetet e ofrimit të ndihmës teknike komunave për të siguruar përshtatshmërinë e ndërtesave shkollore dhe të pajisjeve sipas standardeve ndërkombëtare për shëndet dhe siguri, si dhe për mbrojtje të mjedisit, për të siguruar qasje për nxënës dhe punonjës me aftësi të kufizuara dhe pajisjet ndihmëse për përkrahjen e arsimit gjithëpërfshirës.
10. Më tutje, çdo komunë duhet që vetë apo në bashkëpunim me komunat e tjera të themelojë ekip profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme arsimore, i përbërë nga specialistë të arsimit, të punës sociale, të psikologjisë dhe të rehabilitimit, si mbështetje e jashtme për institucionet arsimore dhe aftësuese për të ofruar këshillime dhe udhëzime për mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit.⁹ Ndërsa nxënësit me të parë të pjesshëm dhe

⁶ Ligji nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20844>

⁷ Ligji Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, (Qëllimi i këtij ligji është që të rregullojë edukimin, arsimin dhe aftësimin parauniversitar nga niveli 0 deri në 4 duke përfshirë arsimin dhe aftësimin e fëmijëve dhe të rriturve që marrin kualifikime në këto nivele. Në veçanti nenet: Neni 39- Nevojat e veçanta arsimore, Neni 40- Parimi i arsimit gjithëpërfshirës, Neni 41- Vlerësimi profesional, Neni 42- Qendrat Burimore, shkollat speciale dhe njësitë që ofrojnë arsimim të veçantë, Neni 43- Gjuha e shenjave dhe sistemi i Braille)

⁸ LAPRK, Neni 3 (3).

⁹ LAPRK, neni 41 si dhe Udhëzimi Administrativ Nr. 16 12/2017 Vlerësimi Pedagogjik i Fëmijëve me Nevoja të Veçanta Arsimore.

ata të verbër kanë të drejtën që të mësohen për përdorimin e alfabetit Brejll, si dhe për ndihmat teknike të nevojshme. Këta nxënës kanë gjithashtu edhe të drejtën për orientimin e nevojshëm dhe për udhëzime gjatë lëvizjes në shkollë, vajtjen dhe kthimin nga shkolla në shtëpi.¹⁰

11. Më specifikisht, format e punës, përdorimi i Planeve Individuale të Arsimit (PIA), vlerësimi profesional i fëmijëve me aftësi të kufizuara, kualifikimet e personelit, kushtet, kriteret si dhe procedurat e provimit të maturës shtetërore janë rregulluar me anë të Udhëzimit Administrativ Nr. 26/2012 Kualifikimet për Personelin që Punon me Nxënësit me Nevoja të Veçanta Arsimore.¹¹
12. Për sa i përket punësimit, Ligji Nr.03/L-019 për Aftësimin dhe Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara (LARPPPAK) përcakton rregullat dhe kushtet për të drejtat, aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me qëllim integrimin e tyre në tregun e punës. Ligji ka për qëllim ofrimin e përkrahjes ligjore dhe institucionale në këtë fushë për personat me aftësi të kufizuara duke u mbështetur në parimin e mundësive të barabarta.¹²
13. Sipas nenit 12 të LARPPPAK-së, të gjitha institucionet publike dhe private, përfshirë edhe organizatat joqeveritare, obligohen që t'i punësojnë personat me aftësi të kufizuara, më saktësisht të punësojnë një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë punëtorë. Në rast të mospunësimit, punëdhënësi obligohet që të paguajë në buxhetin e Kosovës kontribute mujore në lartësi prej një përqind (1%) të shumës së pagës minimale.
14. Sipas LARPPPAK-së, "*aftësimi dhe riaftësimi*" nënkupton ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve nga institucionet përgjegjëse dhe institucionet e tjera për riedukimin e personave me aftësi të kufizuara, me qëllim që atyre t'u mundësohet gjetja e një pune të përshtatshme. Ndërsa "*aftësimi profesional*" synon ndërtimin dhe avancimin e aftësive për të siguruar dhe mbajtur punën si dhe për t'u avancuar nga një vend pune në një vend tjetër, marrë parasysh ndryshimet në teknologji dhe në kushtet e tregut të punës.¹³
15. Masat e poshtshënuara të cilat i parasheh LARPPPAK-ja për aftësim dhe riaftësim janë përcaktuar në nenin 8 dhe duhet të organizohen dhe menaxhohen nga Qendra për Aftësimin, Riaftësimin Profesional e Kosovës, nën kompetencën e Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve. Ndërsa aktivitetet mund të realizohen në institucionet arsimore, në zyrat e punësimit, në qendrat e aftësimit profesional, dhe personat e tjerë juridik, të cilët i plotësojnë kushtet për arsim dhe aftësim profesional, të përcaktuara me këtë ligj dhe me ligjet e tjera të aplikueshme:
 - *përcaktimin e aftësisë mendore për punë;*
 - *informimin, këshillimin profesional dhe vlerësimin e mundësisë profesionale;*
 - *analizimin e tregut për punë, mundësitë për punësim dhe inkuadrimin në punë;*
 - *vlerësimin e mundësisë për aftësimin, riaftësimin dhe hartimin e programeve për aftësim, riaftësim;*

¹⁰ Neni 43, LAPRK.

¹¹ Udhëzimi Administrativ Nr. 26/2012 Kualifikimet për Personelin që Punon me Nxënësit me Nevoja të Veçanta Arsimore.

¹² Neni 3, Ligji Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.

¹³ LARPPPAK, Neni 3.

- aftësimin profesional, kualifikimin plotësues, rikualifikimin me programet e përsosjes dhe mirëmbajtjes së shkathtësive të punës dhe atyre sociale në periudhën derisa të punësohet; informimin dhe këshillimin për procese teknologjike gjatë aftësimit profesional për punësim;
 - programet vetjake dhe të përbashkëta për avancimin e punës sociale dhe integrimi në shoqëri;
 - mësimin profesional, planifikimin dhe aplikimin e teknologjisë së zgjedhur;
 - propozimet këshillëdhënëse mbi aplikimin e teknikave dhe teknologjive të ndryshme në mësim dhe në punë, krahas vlerësimit të mundësive për zbatimin e tyre;
 - ndihmën teknike, përkrahjen përcjelljen dhe vlerësimin e rezultateve; si dhe
 - njoftimin dhe përkrahjen për burimet financiare.
16. Procedurat e aplikimit për njohjen e të drejtave në aftësimin, riaftësimin dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, përcaktimin e vendit të punës, të hapësirës dhe të kushteve të përshtatshme për punë për personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me aftësitë e tyre të punës, përcaktohen me Udhëzimin Administrativ Nr. 03/2010.¹⁴
17. Ligji Nr. 05/L -021 për Mbrojtje nga Diskriminimi përcakton kornizën e përgjithshme për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi edhe në bazë të aftësisë së kufizuar. Ky ligj zbatohet për të gjitha veprimet apo mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore dhe lokale, të personave fizikë dhe juridikë, të sektorit publik dhe privat, të cilët shkelin, kanë shkelur ose mund të shkelin t'i drejtat e çdo personi në të gjitha fushat e jetës, duke përfshirë edhe arsimin e punësimin.¹⁵
18. Ligji Nr. 03/L-212 i Punës rregullon të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, siç përcaktohen me këtë ligj, për të gjithë të punësuarit në Republikën e Kosovës. Neni 5, paragrafi 2, ndalon diskriminimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të personave me aftësi të kufizuara gjatë punësimit, avancimit në punë dhe avancimit profesional, nëse për atë vend pune është i aftë ta kryejë punën në mënyrë adekuate.¹⁶
19. Ligji Nr. 08/L-153 për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme përcakton të drejtën e çdo fëmije, pavarësisht nga aftësitë e tyre, për të marrë një edukim të plotë dhe të përshtatshëm. Gjithashtu kërkon që sistemi arsimor të ofrojë mundësi dhe resurse për t'i përmirësuar aftësitë e fëmijëve me aftësi të kufizuara në mënyrë që ata të jenë në gjendje ta zhvillojnë potencialin e tyre maksimal. Ligji në fjalë përcakton të drejtën e fëmijëve me aftësi të kufizuara për të marrë një trajtim të individualizuar dhe për të qenë të përfshirë në ambientin arsimor më të gjerë. Në përgjithësi, ligji për edukimin në fëmijërinë e hershme synon të sigurojë që çdo fëmijë ta ketë të drejtën për një arsimim të barabartë dhe cilësor, duke ia ofruar atij mundësinë për të arritur sukses në të ardhmen.¹⁷
20. Rrjedhimisht, Republika e Kosovës ka vendosur një kornizë të përgjithshme ligjore për të mbrojtur dhe realizuar gjithëpërfshirjen e fëmijëve në institucionet arsimore dhe të drejtën

¹⁴ Udhëzimi Administrativ nr. 03/2010 për Procedurat e Aplikimit për Njohjen e të Drejtave në Aftësim, Riaftësim dhe Punësim të Personave me Aftësi të Kufizuara.

¹⁵Neni 2, Ligji Nr. 05/L -021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

¹⁶ Ligji nr. 03/L-212 i Punës, neni 5.

¹⁷ Ligji për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, nenet 1 dhe 3.

e fëmijëve dhe të rinjve në arsim si dhe mbrojtjen nga diskriminimi, si të drejta themelore në përputhje me tekstin dhe frymën e kornizës kushtetuese në Kosovë.¹⁸

ARSIMI GJITHËPËRFSHIRËS I CILI PËRGATIT PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

21. Gjithëpërfshirja sociale është e ndërlidhur me ndjenjën e përkatësisë, pranimin dhe njohjes së diversitetit të personit. Vlerat kryesore prapa gjithëpërfshirjes sociale janë të bazuara në parimet që vlerësojnë diversitetin, por në të njëjtën kohë premtojnë mbështetje për njëri-tjetrin, si: çdonjëri ka nevojë për mbështetje, çdonjëri mund të kontribuojë, çdonjëri mund të komunikojë dhe çdonjëri është i gatshëm.¹⁹ Arsimi gjithëpërfshirës është një nga mekanizmat më të rëndësishëm, që synon të sigurojë promovimin dhe zgjerimin e konceptit të gjithëpërfshirjes sociale.
22. Arsimi gjithëpërfshirës ka të bëjë me mënyrën se si institucionet i zhvillojnë dhe i dizajnojnë shkollat, klasat, programet dhe aktivitetet mësimore, në mënyrë që të gjithë të mësojnë dhe të marrin pjesë së bashku. Gjithashtu, arsimi gjithëpërfshirës nënkupton se të gjithë ndjekin dhe mirëprehen nga shkollat/qendrat e arsimit profesional, të cilat ofrojnë mbështetje për të nxënë, kontribuar dhe marrë pjesë në të gjitha aspektet e jetës shkollore.²⁰
23. Arsimi gjithëpërfshirës ka të bëjë me sigurimin e qasjes në arsim cilësor për të gjithë personat me prejardhje të ndryshme dhe me aftësi të ndryshme duke përmbushur në mënyrë efektive nevojat e tyre të ndryshme, ashtu që të gjithë marrin pjesë në programe/trajnime arsimore/profesionale në një mjedis të përbashkët mësimor. Përmes nocionit të arsimit gjithëpërfshirës synohet që të gjithë nxënësit të marrin mbështetjen e duhur dhe të hiqen barrierat, që mund të çojnë në përjashtim të ndonjë nxënësi apo grupi të caktuar shoqëror.²¹ Arsimimi i mirëfilltë gjithëpërfshirës përgatit qytetarët të jenë të aftë dhe të shkathtë të jetojnë të pavarur, të orientohen për karrierë dhe të konkurrojnë në tregun e punës. Investimi në edukim e formim profesional është shumë i rëndësishëm për t'i tejkaluar barrierat e tregut të punës.²² Personat me aftësi të kufizuara janë më pak të përfshirë në botën e punës së paguar.²³
24. Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP) hartoi standardet për punonjësit me aftësi të kufizuara. Rekomandimi nr. 99 thekson rëndësinë e integritit në vendin e punës të punonjësve me aftësi të kufizuara. Me kalimin e viteve u theksua ideja se politikat e

¹⁸ Kushtetuta, nenet 47 (1) dhe 50 (4).

¹⁹ Kombet e Bashkuara, *Matja e përfshirjes sociale: Rregullat dhe praktikat*. Nju Jork: Kombet e Bashkuara, 2010 në: <https://www.un.org/esa/socdev/publications/measuring-social-inclusion.pdf>.

²⁰ UNICEF. *Edukimi gjithëpërfshirës: Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në mësim të cilësisë: Çfarë duhet të bëhet?* Nju Jork, 2017. në: https://www.unicef.org/eca/sites/unicef.org/eca/files/IE_summary_accessible_220917_brief.pdf.

²¹ Po aty.

²² Heron, Robert, dhe Barbara Murray. *Ndihma për personat me aftësi të kufizuara për të gjetur punë: Një udhëzues praktik. Edicioni Azi dhe Paqësor* (Edicioni i 2-të). Gjenevë: ILO, 2003. ISBN 92-2-115116-6. PDF: <http://www.ilo.org/disability>.

²³ Marin, Bernd, Christopher Prinz, dhe Monika Queisser. *Transformimi i Politikave të Mirëqenies për Aftësinë e Kufizuar: Drejt Punës dhe Mundësive të Barabarta*. Aldershot, MB: Ashgate, 2004. https://www.berndmarin.eu/wp-content/uploads/2017/07/2004-Transforming-Disability-Welfare-Policies_Towards-Work-and-Equal-Opportunities.pdf.

punësimit për personat me aftësi të kufizuara mund të jenë të suksesshme vetëm nëse ato bëhen pjesë e politikave të punësimit për të gjithë.²⁴

25. Të gjithë fëmijët kanë të drejtë të barabartë për arsim themelor, të detyrueshëm dhe cilësor. Të gjithë fëmijët kanë të drejtë të kenë qasje, përkushtim, rritje të pjesëmarrjes dhe cilësi në procesin e mësimi pavarësisht moshës, gjinisë, përkatësisë etnike, racore, shëndetësore, nivelit shoqëror, ekonomik dhe aftësive e mundësive. Arsimi gjithëpërfshirës siguron njohje, pranim dhe respekt për të gjithë fëmijët.
26. Andaj është e drejta e çdo fëmije të arsimohet në shkollë dhe të trajtohet me dinjitet. Mësimdhënia duhet t'u përshtatet specifikave, nevojave dhe mundësive të çdo nxënësi. Shkollë duhet të jetë e qasshme për të gjithë fëmijët dhe për vijimin e saj, të gjithë të kenë shanse të barabarta, pavarësisht nga aftësitë që ka secili.

Dokumentet e politikave dhe institucionet që punojnë në përfshirjen e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara në Kosovë

27. Personat me aftësi të kufizuar përfshijnë individët me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë.²⁵ Përkundër përfshirjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në legjislacionin kombëtar, zbatimi i këtyre dispozitave ka hasur në pengesa të ndryshme.
28. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) ka hartuar Planin Strategjik 2022-2026, ku përmirësimi të qasjes dhe pjesëmarrjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara u është kushtuar vëmendje në të gjitha nivelet arsimore. Plani parasheh sigurimin e qasjes së barabartë për fëmijët me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor dhe në resurset arsimore të nevojshme për të përmirësuar aftësinë e tyre, zhvillim të programeve arsimore të personalizuar dhe të pranueshme për fëmijët me aftësi të kufizuara duke u bazuar në nevojat dhe aftësitë e tyre të veçanta, rritja e numrit të mësimdhënësve mbështetës për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, promovimin e bashkëpunimit dhe koordinimin mes institucioneve arsimore, prindërve dhe komunitetit për të siguruar një mjedis të mirë për fëmijët nga grupet e marginalizuara.²⁶
29. Në vitin 2015 është themeluar Këshilli Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuar, i cili ka për qëllim të punojë në zbatimin dhe monitorimin e politikave nacionale për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar. Ky këshill është krijuar për të punuar për krijimin e mundësisë së barabartë, pjesëmarrjen e plotë dhe integrimin e personave me aftësi të kufizuar, po ashtu sigurohet që nevojat dhe interesat e personave me aftësi të kufizuar të merren parasysh gjatë vendimeve të qeverisë. Mirëpo, kohët e fundit këshilli nuk është aktiv.²⁷
30. Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar (FKAK) është një organizatë ombrellë dhe mekanizëm gjithëpërfshirës i tetë organizatave të personave me aftësi të kufizuar në Kosovë. Misioni i kësaj organizate ombrellë, në të cilën janë të anëtarësuara të gjitha

²⁴ ILO. *Formimi për punësim dhe punë të mirë për paqen dhe qëndrueshmërinë: Një udhëzues praktik për organizatat që synojnë rimëkëmbjen ekonomike dhe sociale*. Gjenevë: ILO, 2015. PDF: https://www.ilo.org/sites/default/files/wcmsp5/groups/public/@ed_emp/@ifp_skills/documents/publication/wcms_407645.pdf.

²⁵ KDKPAK, Neni 1.

²⁶ MASHTI - Plani Strategjik 2022-2026.

²⁷ Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës 2013-2023.

organizatat e personave me aftësi të kufizuar në Kosovë, është të adresojë dhe avokojë për çështje të rëndësishme që prekin jetën e personave me aftësi të kufizuar. Forumi në kuadër të tij ka të anëtarësuar gjithsej tetë (8) organizata, që veprojnë në fusha të ndryshme për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar në Kosovë: 1. Down Syndrome Kosova; 2. HandiKos; 3. Handikep Kosova; 4. Klubi “Dëshira”; 5. Organizata e Prindërve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar; 6. Shoqata e Autizmit; 7. Shoqata Kosovare e të Shurdhërve; 8. Shoqata e të Verbërve të Kosovës.²⁸ Ky forum është mjaft aktiv dhe ka hartuar edhe raport për zbatimin e strategjisë nacionale për personat me aftësi të kufizuar.²⁹ Ky raport ka gjetur se për sa i përket arsimit gjithpërfshirës: janë hartuar politika dhe janë zhvilluar aktivitete të ndryshme, siç janë: trajnime për personel dhe krijimi i bazave të të dhënave. Për më tepër, ka pasur një bashkëpunim të frytshëm me organizata ndërkombëtare. Megjithatë, zbatimi i këtyre politikave ka hasur në sfida të shumta. Shumë nga aktivitetet e planifikuara në strategji nuk janë zbatuar në mënyrë të plotë, duke lënë pas dore nevoja specifike të personave me aftësi të kufizuara. Mungesa e një financimi të dedikuar, koordinimi i dobët ndërmjet institucioneve dhe mungesa e një qasjeje të individualizuar në arsim janë disa nga shqetësimet kryesore të ngritura. Për më tepër, edhe pse janë organizuar disa fushata për ngritjen e vetëdijes, personat me aftësi të kufizuara, veçanërisht ata me aftësi të kufizuara vizuale dhe auditive, ende përballen me pengesa për qasje në informacion dhe në shërbime arsimore.³⁰

Gjithëpërfshirja në shkollat fillore dhe në të mesmet

31. Gjithëpërfshirja është një koncept shumë më i gjerë se koncepti i integritetit. Shkollë gjithëpërfshirëse është ajo shkollë, në të cilën ndryshimet mes nxënësve dhe diversiteti janë të mirëpritura dhe merren masat e nevojshme për ta realizuar këtë. Andaj, gjithëpërfshirja kërkon që nevojat e ndryshme të të gjithë nxënësve të gjejnë mundësi të realizohen e për këtë shkolla ndërmerr organizimin e strukturave dhe ndryshimeve të nevojshme për t'i mundësuar çdo nxënës arritjen e maksimumit të përfitimit nga pjesëmarrja në shkollë.
32. Në anën tjetër, nxënës me aftësi të kufizuara konsiderohet: *“Nxënësi i cili ka dëmtime afatgjata fizike, mendore, shqisore, të sjelljes ose të kombinuara të cilat, në ndërveprim me barriera të tjera, mund ta pengojnë të marrë pjesë në mënyrë të plotë dhe të barabartë në arsimimin e tij dhe në jetën shoqërore.”*³¹
33. Për të lehtësuar përfshirjen e të gjithë nxënësve, përfshirë edhe ata me aftësi të kufizuara, është i nevojshëm zhvillimi i politikave dhe i praktikave në nivel shkolle. Të gjithë: shkolla, nxënësi, prindër, drejtues e administratorë duhet të përpiqen të eliminojnë dhe pakësojnë të gjithë ata faktorë që krijojnë veçimin, ndrojtjen dhe qëndrimet negative për të pranuar dhe mësuar çdo nxënës. Është shumë e rëndësishme që në fazën e shkollimit këta fëmijë të jenë pjesë e komunitetit shkollor, përndryshe, më vonë u vështirësohet qasja në komunitetin më të gjerë shoqëror.

²⁸ <http://kdf-ks.org/per-ne/>

²⁹ FARK, Niveli i Zbatimit të Strategjisë Nacionale për Personat me Aftësi të Kufizuar, në: <https://kdf-ks.org/wp-content/uploads/2018/09/Raporti-mbi-Zbatimin-e-Strategjis%C3%AB-Nacionale-p%C3%ABr-Persona-me-Aft%C3%ABsi-te-Kufizuara-n%C3%AB-Kosov%C3%AB.pdf>

³⁰ Po aty, fq.20-29.

³¹ HANDIKOS, Doracak për qasjen dhe terminologjinë e drejtë për personat me aftësi të kufizuar, 2016, në: http://handi-kos.org/wp-content/uploads/2004/03/DORACAKU_GQZ_ALB_966740.pdf

34. Përfshirja e nxënësve me aftësi të kufizuara në jetën e shkollës duhet të planifikohet edhe në nivel shkollë, që do të thotë se çfarë politikash dhe praktikash të nevojshme duhet të zhvillojë shkolla. Çdo shkollë duhet të përfshijë në dokumentet bazë, procedura për arsimimin dhe edukimin e nxënësve me aftësi të kufizuara duke filluar nga momenti i regjistrimit të fëmijës në shkollë e deri në përshtatjen e plotë të tij në shkollë.³²
35. MASHTI ka përgatitur edhe një doracak mbi gjithëpërfshirjen në institucionet arsimore të fëmijëve me nevoja të veçanta “*Edhe fëmiju im ka të drejtë të arsimohet*”, i cili është hartuar me qëllim të lehtësimit të punës së të gjitha palëve që përfshihen në cilëndo fazë të gjithëpërfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në arsim, duke filluar nga institucionet në nivel qendror, nivel lokal, shkolla e deri tek prindërit. Ky doracak fillimisht shpjegon kompetencat që i kanë institucionet e vendit në bërjen e politikave rreth gjithëpërfshirjes së personave me nevoja të veçanta. Më pas fokusohet tek rolet dhe përgjegjësitë e të gjitha institucioneve në ofrimin e shërbimeve për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, duke filluar nga MASHTI, DKA-të e deri tek shkollat.³³
36. Sipas Raportit të IAP-së *ex officio* nr.331/2022 lidhur me përafrimin e dispozitave të sistemit të arsimit të përgjithshëm parauniversitar me të drejtat e fëmijëve në arsim, pjesëmarrja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor është e ulët. Kjo si rezultat i nivelit të vetëdijesimit shoqëror ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe kapacitetit të kufizuar të sistemit për të ofruar shërbime arsimore dhe rehabilituese për ta. Raporti konstaton se sfidë vazhdon të mbetet edhe mungesa e një sistemi gjithëpërfshirës për mbledhjen e të dhënave dhe qasjes ndërsektoriale për fëmijët me aftësi të kufizuara në sektorin e arsimit, duke e vështirësuar planifikimin e shërbimeve nga drejtoritë komunale dhe nga vetë shkollat. Nga ana tjetër, shkollat po ashtu kanë kapacitete shumë të kufizuara për ta promovuar gjithëpërfshirjen duke qenë se mësimdhënësit në shkollat e rregullta nuk kanë trajnim adekuat për të punuar me fëmijët me aftësi të kufizuara.³⁴
37. Avokati i Popullit, në kuadër të mandatit të tij për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, i ishte drejtuar përmes e-mailit Drejtorive Komunale të Arsimit në Kosovë³⁵ me kërkesë për informata lidhur me mënyrën e organizimit të transportit për fëmijët me aftësi të kufizuara për ndjekjen e procesit mësimor. Kjo kërkesë synonte të vlerësojë nëse janë marrë masat e nevojshme për të garantuar qasjen e barabartë në arsim dhe për të siguruar kushte adekuate për këtë kategori fëmijësh, duke adresuar kështu obligimet ligjore dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e tyre.
38. Në bazë të rasteve të hetuara për vitin 2023, IAP-ja ka vlerësuar se problemet të cilat e vështirësojnë qasjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim vazhdojnë të mbeten probleme zinxhirore, të cilat përfshijnë katër fusha kyçe: mungesën e vlerësimit të hershëm të aftësisë së kufizuar; diskriminimin për qasje në institucione parashkollore; mungesën e transportit dhe asistentëve personalë; si dhe të planeve individuale të

³² Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën (UNESCO). (2017). Udhëzues për sigurimin e përfshirjes dhe barazisë në arsim, Paris, France: UNESCO, e qasshme në: <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000248254>.

³³ MASHTI, “*Edhe fëmiju im ka të drejtë të arsimohet*”, i qasshëm në: <https://masht.rks-gov.net/materiale-te-ndryshme/>

³⁴ Institucioni i Avokatit të Popullit, Raport ex-officio nr.331/2022 lidhur me përafrimin e dispozitave të sistemit të arsimit të përgjithshëm parauniversitar me të drejtat e fëmijëve në arsim, fq.20-29, i qasshëm në: <https://oik-rks.org/2022/11/10/raporti-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-3312022-lidhur-me-perafrimin-e-dispozitave-te-sistemit-te-arsimit-te-pergjithshem-parauniversitar-te-kosoves-me-te-drejtat-e-femijeve-ne-arsim/>

³⁵ Komuna e Klinës, Kaçanikut, Rahovecit, Obiliqit, Lipjanit, Gjakovës, Vitisë dhe Junikut I janë përgjigjur kërkesës së IAP për informata.

mësimi. Shkaqet e këtyre shkeljeve janë të shumëfishta dhe përfshijnë mungesën e zbatimit të ligjeve ekzistuese, burime të pamjaftueshme financiare, mungesën e kapaciteteve të mjaftueshme në shkolla dhe në komunë, si dhe mungesën e një bashkëpunimi të mirëfilltë midis institucioneve të ndryshme. Për ta adresuar këtë situatë, është e nevojshme të ndërmerren hapa konkretë për të forcuar zbatimin e ligjeve, për të rritur financimin për arsimin gjithpërfshirës, për të trajnuar stafin e shkollave dhe për të krijuar ekipe shumëdisiplinore për të vlerësuar dhe përkrahur fëmijët me aftësi të kufizuara.³⁶

39. Komunitet janë të obliguara të themelojnë ekipe profesionale vlerësuese dhe përkrahëse për nevojat e posaçme arsimore për fëmijët me aftësi të kufizuara. LAP-i obligon institucionet e përfshira në ofrimin e arsimit parauniversitar që të planifikojnë dhe të ofrojnë shërbime efikase, efektive, fleksibile, gjithëpërfshirëse dhe profesionale, të dizajnuara për t'u ofruar të gjithë fëmijëve të drejtat e barabarta për shkollim, në pajtim me aftësitë dhe nevojat e tyre specifike, si dhe për ta avancuar zhvillimin e tyre arsimor e social. Në Raportin e IAP-së, *Ex officio nr.411/2021 në lidhje me themelimin e ekipit profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme arsimore për fëmijet me aftësi të kufizuara*, Avokati i Popullit kishte konstatuar se 17 komuna kishin dështuar t'i përmbushnin detyrimet kushtetuese dhe ligjore për themelimin e këtyre ekipeve vlerësuese.³⁷

³⁶ IAP, Raporti Vjetor 2023, Të drejtat e Fëmijëve, i qasshëm në: <https://oik-rks.org/2024/03/29/>

³⁷ Raport i Avokatit të Popullit ex officio nr. 411/2021, në lidhje me themelimin e ekipit profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme arsimore për fëmijët me aftësi të kufizuara, i qasshëm në: <https://oik-rks.org/2022/04/27/raport-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-nr-4112021-ne-lidhje-me-themelimin-e-ekipit-profesional-vleresues-dhe-perkrahes-per-nevojat-e-posacme-arsimore-per-femijet-me-aftesi-te-kufizuara/>

9.2. Numri i nxënësve sipas llojit të dëmtimit

Tabela 30. Nxënësit sipas klasave dhe llojit të dëmtimit

Mosha/Klasa	Dëmtime intelektuale	Dëmtime në të dëgjuar	Dëmtime në të parë	Dëmtime fizike	Dëmtime të shumëfishta	Vësht. në të folur, komunik. dhe të gjuhës	Autizëm	Çrregullime emocionale dhe të sjelljes	Sindromi Daun	Gjithsej
3 - 4 vjeç	3	1	-	-	1	9	-	-	-	14
5 - 6 vjeç	2	1	4	-	38	9	-	-	-	54
Klasa 1	6	2	2	-	5	-	5	-	1	21
Klasa 2	5	2	1	-	5	-	2	-	-	15
Klasa 3	9	1	-	-	6	-	-	-	1	17
Klasa 4	7	3	-	-	1	-	1	2	-	14
Klasa 5	7	2	2	-	2	-	3	-	-	16
Klasa 6	4	3	1	-	6	-	1	3	2	20
Klasa 7	9	4	-	-	6	-	1	-	-	20
Klasa 8	8	5	2	-	4	1	2	1	1	24
Klasa 9	2	2	2	1	7	-	5	1	3	23
Klasa 10	14	3	2	-	8	-	-	-	2	29
Klasa 11	12	4	3	-	7	-	1	1	4	32
Klasa 12	18	7	4	-	12	2	2	2	3	50
Gjithsej	106	40	23	1	108	21	23	10	17	349

9. Arsimi special

9.1. Numri i nxënësve në Qendrat Burimore/shkolla speciale

Tabela 29. Nxënësit sipas klasave në shkolla speciale

Grupmosha/Klasa	Shkolla speciale/Qendra Burimore		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej
3 - 4 vjeç	11	3	14
5 - 6 vjeç	34	20	54
Klasa 1	13	8	21
Klasa 2	11	4	15
Klasa 3	10	7	17
Klasa 4	11	3	14
Klasa 5	6	10	16
Klasa 6	15	5	20
Klasa 7	11	9	20
Klasa 8	11	13	24
Klasa 9	15	8	23
Klasa 10	16	13	29
Klasa 11	13	19	32
Klasa 12	29	21	50
Gjithsej	206	143	349

INFORMACION PËR

Nxënësit me nevoja të veçanta në klasat e rregullta*

Klasë	Dëmtime intelektuale	Dëmtime në të dëgjuar	Dëmtime në të parë	Dëmtime fizike	Dëmtime të shumfishta	Vështirësi në të folur, komunikim dhe të gjuhës	Autizëm	Çrregullime emocionale dhe të sjelljes	Vështirësi /Çrregullime në të mënë	Deprivimet sociale, kulturore dhe gjuhësore	Sindromi Daun	Gjithsej
Gr. 1-2	4	-	1	-	-	4	-	-	-	-	3	12
Gr. 2-3	-	-	1	-	-	13	3	-	-	-	3	20
Gr. 3-4	7	7	2	-	3	26	5	1	-	-	6	57
Gr. 4-5	12	11	2	-	16	15	12	5	1	1	5	80
Gr. 5-6 - parash./gëd	3	1	1	3	8	16	24	4	2	-	6	68
Gr. 5-6 - paraf.	67	11	36	7	46	69	10	14	7	-	19	286
Klasa 1	36	13	95	17	34	74	12	19	32	1	8	341
Klasa 2	38	11	101	15	27	60	10	24	52	-	11	349
Klasa 3	65	12	74	24	37	68	12	14	52	-	10	368
Klasa 4	51	11	119	9	10	44	10	25	52	1	14	346
Klasa 5	63	8	86	16	40	48	7	22	46	-	36	372
Klasa 6	57	13	116	26	36	39	10	17	26	3	5	348
Klasa 7	58	13	77	10	31	39	6	12	26	1	9	282
Klasa 8	45	12	88	15	20	22	2	16	20	1	2	243
Klasa 9	50	5	87	25	35	28	8	18	18	1	22	297
Klasa 10	16	8	80	13	12	9	1	1	1	-	2	143
Klasa 11	59	11	41	9	11	8	1	3	4	-	7	154
Klasa 12	24	12	36	15	22	13	3	6	3	-	3	137
Klasa 13	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	655	159	1,043	204	388	595	136	201	342	9	171	3,903

* Te dhënat e nxënësve me nevoja të veçanta dhe saktësia e këtyre të dhënave është komplekse për faktin që akoma nuk janë vlerësuar të gjithë nxënësit me nevoja të veçanta që janë në klasat e rregullta nga ekipet vlerësuese profesionale në komuna.

40. Sipas MASHTI-t, në vitin shkollor 2020-2021 në shkollat e rregullta ishin gjithsej 3 939 nxënës me aftësi të kufizuar, ndërkaq në qendra burimore/shkolla speciale ishin 307 nxënës, nga ta 186 djem dhe 121 vajza.³⁸ Në vitin 2021/22 gjithsej 3 965 nxënës me aftësi të kufizuar ishin në shkollat e rregullta, ndërkaq në qendra burimore/shkolla speciale ishin gjithsej 291 nxënës, nga ta 185 djem dhe 106 vajza.³⁹ Në vitin shkollor 2022/23 ishin gjithsej 3 903 nxënës me aftësi të kufizuar në shkollat e rregullta, ndërkaq në qendra burimore/shkolla speciale ishin gjithsej 313 nxënës, nga ta 209 djem dhe 104 vajza.⁴⁰ Në qendrat burimore në nivelin parashkollor/parafillor vijnë mësimin 52 fëmijë, 32 djem dhe 20 vajza. Më tutje, në nivelin e mesëm të ulët vijnë mësimin 180 nxënës, 129 djem dhe 51 vajza, si dhe në të mesëm të lartë janë 48 djem dhe 33 vajza, gjithsej 81 nxënës.

³⁸Të dhënat e disagreguara për aftësinë e kufizuar i gjeni në raportin <https://masht.rks-gov.net/statistikat-e-arsimit-ne-kosove-2020-21/>, faqe 53, 54 dhe 68, si dhe në raportin: <https://masht.rks-gov.net/shenime-statistikore-2020-21/>.

³⁹Të dhënat e ndara sipas llojit të dëmtimeve gjeni në raportin: *Statistikat e arsimit në Kosovë 2021-22*: <https://masht.rks-gov.net/statistikat-e-arsimit-ne-kosove-2021-2022/>, faqe 53, 55 dhe 68, si dhe në raportin: <https://masht.rks-gov.net/shenime-statistikore-2021-22/>

⁴⁰Shih raportin me të dhëna sipas klasave dhe dëmtimeve, faqe 55, 57 dhe 71: <https://masht.rks-gov.net/statistikat-e-arsimit-ne-kosove-2022-2023> dhe në raportin <https://masht.rks-gov.net/shenime-statistikore-2022-23-arsimi-parauniversitar/>

Në anën tjetër, Raporti për Kosovën për vitin 2023 i Komisionit të Bashkimit Evropian ka vlerësuar se rreth 38 000 fëmijë me aftësi të kufizuara nuk ndjekin shkollën.⁴¹

Shkollat e mesme të larta dhe profesionale

41. Shkollat profesionale, të cilat shihen si një mundësi e mirë për t'i përgatitur personat me aftësi të kufizuara të konkurrojnë në tregun e punës, nuk janë të përgatitura mirë ta përkrahin këtë grup të nxënësve. Përderisa është punuar në ndryshime edhe në arsimimin profesional, këto ndryshime kryesisht janë iniciativa nga organizatat dhe agjenci të ndryshme.
42. Problemi në arsimin e mesëm të lartë qëndron te mungesa e shërbimeve mbështetëse dhe aftësimi i mësimdhënësve, fatkeqësisht edhe pse nxënësit orientohen për shkollë të mesme profesionale, ata nuk arrijnë ta zotërojnë profesionin dhe si rrjedhojë, një numër i vogël i tyre zotërojnë kompetencat dhe shkathhtësitë e duhura për të konkurruar në tregun e punës.
43. Që nga viti 2021 ekziston edhe Udhëzuesi për shkollat profesionale (dhe gjimnazet) për përkrahjen e nxënësve me aftësi të kufizuara. Ky udhëzues, i hartuar për orientimin e nxënësve me aftësi të kufizuara, jep shpjegime të qarta prej momentit të regjistrimit e deri te përfundimi i shkollimit. Shkollat duhet të jenë të afta ta përgatisin Planin Individual të Arsimit - PIA dhe cilat kompetenca duhet të përshtaten për personin e caktuar, e kjo duhet të reflektojë në diplomën e tij/saj, ashtu që punëdhënësi e ka të qartë se cilat kompetenca i zotërojnë. Udhëzuesi orienton nxënësit edhe si duhet bërë adoptimi i kompetencave për nxënës të caktuar, për draftimin e PIA-s, si dhe cilat janë obligimet e personelit shkollor në raport me nxënësit me aftësi të kufizuara, por mungon një pasqyrë reale se sa ka filluar të aplikohet ky udhëzues.⁴²
44. Për nxënësit me aftësi të kufizuara, sfidat mbeten në formë të qasjes së kufizuar në arsimin e përshtatshëm, në shërbime shëndetësore dhe riaftësuese, qasja pa barrierë në objekte dhe në shërbime publike.

Qasja në tregun e punës e personave me aftësi të kufizuara

45. Përgatitja profesionale e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë është sfiduese në mungesë të qasjes fizike, qasjes në informacione dhe kompetencave profesionale të stafit të institucioneve arsimore dhe aftësuese. Pjesa më e madhe e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë hasin në vështirësi gjatë përgatitjes profesionale për integrim në tregun e punës. Vështirësitë në përgatitjen profesionale fillojnë që nga fazat shumë të hershme të arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Sfidat vazhdojnë përgjatë gjithë shkollimit parauniversitar, përfshirjes në qendrat e aftësimit profesional apo në institucionet e arsimit të lartë. Mungesa e qasjes fizike, e qasjes në informacione dhe kompetencat e limituara të stafit profesional të institucioneve arsimore dhe aftësuese janë vetëm disa nga barrierat më të mëdha që e pengojnë aftësimin profesional të personave me aftësi të kufizuara në Kosovë. Institucionet arsimore shpeshherë nuk ofrojnë qasjen e duhur fizike për personat me aftësi të kufizuara fizike dhe në veçanti për përdoruesit e karrocës. Mungesa e ashensorëve, e rampave dhe e tualeteve të përshtatshme janë vetëm

⁴¹ Komisioni i Bashkimit Evropian, Raporti për Kosovën 2023, fq. 106, 2023, në: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/760aacca-4e88-4667-8792-3ed08cdd65c3_en?filename=SWD_2023_692%20Kosovo%20report_0.pdf

⁴² MASHTI, Udhëzuesi i hartuar për orientimin e nxënësve me aftësi të kufizuara, 2021.

disa nga faktorët që e pengojnë qasjen e personave me aftësi të kufizuara në institucione shkollore.

46. Në Raportin e Avokatit të Popullit, *ex officio* nr. 676/2022-Arsimimi dhe mundësitë e të rinjve dhe mundësitë e të rinjve në tregun e punës, Avokati i Popullit vlerësoi nivelin e harmonizimit të arsimit të të rinjve në institucionet e arsimit të lartë dhe profesional të Kosovës me kushtet e tregut të punës, me qëllim të zbatimit të dispozitave kushtetuese dhe ligjore për respektimin e të drejtave të fëmijëve në arsim. Raporti konstaton se arsimi dhe aftësimi profesional në Kosovë po përballen me disa sfida serioze, që pengojnë përputhjen e profilit shkollor të nxënësve me kërkesat e tregut të punës. Së pari, mungesa e të dhënave të sakta dhe të përditësuara për tregun e punës pengon planifikimin e një profili shkollor adekuat. Së dyti, mungesa e akreditimit të institucioneve arsimore dhe programeve të studimit ndikon në cilësinë e arsimit të ofruar. Së treti, buxhetet e pamjaftueshme, mungesa e pajisjeve dhe e materialeve mësimore, si dhe mungesa e mundësive për mësim në vendin e punës po ndikojnë negativisht në cilësinë e arsimit profesional. Përveç këtyre, edhe mungesa e një sistemi të qartë për orientimin e studentëve, si dhe mungesa e një mekanizmi të rregullt për vlerësimin dhe parashikimin e nevojave të tregut të punës po kontribuojnë në këtë problematikë. Si rezultat, arsimi profesional nuk po konsiderohet si një zgjedhje atraktive për nxënësit, ndërsa shumë të punësuar po punojnë në fusha të ndryshme nga ato për të cilat kanë studiuar. Për t'i adresuar këto sfida, është e nevojshme të ndërmerren hapa konkretë për të përmirësuar koordinimin midis sektorit të arsimit dhe atij të punësimit, për të forcuar sistemet e akreditimit dhe të monitorimit të cilësisë së arsimit, si dhe për të investuar në zhvillimin e kapaciteteve të institucioneve arsimore dhe të mësimdhënësve. Tutje raporti rekomandon rishikimin e formulës së financimit për shkollat profesionale, trajnime për mësimdhënësit dhe fushata informuese për prindërit dhe nxënësit.⁴³
47. Nga ana tjetër, edhe qasja në informacione për personat e verbër dhe ata të shurdhër është sfiduese. Sipas Shoqatës së të Verbërve të Kosovës: “*Shkollat e rregullta në Kosovë nuk posedojnë as kushtet minimale për gjithëpërfshirjen e fëmijëve të verbër në arsim.*”⁴⁴ Mungesa e literaturës në Braille, teknologjisë asistuese dhe qasjes taktile në objekte e vështirësojnë dhe shpeshherë e bëjnë të pamundur integrimin e fëmijëve të verbër në procesin mësimor. Me të njëjtat sfida përballen edhe të rinjtë në arsimin e lartë apo në Qendrat e Aftësimit Profesional (QAP). Kjo ua pamundëson atyre që t'i profilizojnë aftësitë dhe shkathtësitë e tyre për punë e rrjedhimisht edhe të jenë mjaftueshëm të përgatitur sa për t'i plotësuar kërkesat e tregut e punës. Sipas Shoqatës së të Verbërve të Kosovës, vetëm rreth 20 të rinj nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të tyre kanë përfunduar studimet universitare. Megjithatë, edhe ky grup vazhdimisht është përballur dhe po përballen me vështirësi për t'u integruar në tregun e punës.
48. Avokati i Popullit ka identifikuar disa sfida dhe mungesa në punësimin e personave me aftësi të kufizuara në institucionet qendrore dhe në organet e vetëqeverisjes lokale në Kosovë, në Raportin e Avokatit të Popullit, *Ex-officio* numër 519/2022 në lidhje me punësimin në institucionet qendrore dhe në organet e vetëqeverisjes lokale në Kosovë të

⁴³ Institucioni i Avokatit të Popullit, Raporti i Avokatit të Popullit, *Ex-officio* rasti nr. 676/2022 – arsimimi dhe mundësitë e të rinjve në tregun e punës, i qasshëm në: <https://oik-rks.org/2023/04/06/raporti-i-avokatit-te-popullit-ex-officio-rasti-nr-6762022-arsimimi-dhe-mundesite-e-te-rinjve-ne-tregun-e-punes/>

⁴⁴ Komunikim me përfaqësuesin e Shoqatës së të Verbërve të Kosovës.

personave me aftësi të kufizuara. Disa nga pikat kyçe dhe konstatimet e raportit janë: mungesa e strategjive dhe e politikave të qarta për t'i promovuar dhe për t'i mbrojtur të drejtat dhe interesat e personave me aftësi të kufizuara në fushën e punësimit, një numër i kufizuar i personave me aftësi të kufizuara punojnë në institucionet qendrore dhe në organet e vetëqeverisjes lokale, duke treguar nevojën për një angazhim më të madh për të siguruar barazi në punësim, mungesë të ofertave të mjaftueshme dhe të përshtatshme për trajnime dhe zhvillim profesional për personat me aftësi të kufizuara, nevojën për një bashkëpunim me të mirë midis institucioneve dhe organizatave qeveritare dhe joqeveritare për t'i adresuar nevojat dhe sfidat e personave me aftësi të kufizuara në fushën e punësimit. Në përgjithësi, raporti thekson nevojën për një angazhim me të madh dhe përmasa të reja për të siguruar barazi në punësim për personat me aftësi të kufizuara në Kosovë.⁴⁵ Raporti thekson se diskriminimi në punësim është i pranishëm, personat me aftësi të kufizuara me arsim të lartë e kanë të vështirë të gjejnë punë në profesionin e tyre si dhe se institucionet qendrore dhe lokale nuk e respektojnë ligjin për punësimin e personave me aftësi të kufizuar. Sipas këtij raporti, tri ministri: Ministria e Ekonomisë, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim nuk e kanë punësuar asnjë person me aftësi të kufizuar duke mos i përmbushur obligimet ligjore; kurse gjashtë ministri: Ministria e Drejtësisë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diaspora, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë kanë punësuar persona me aftësi të kufizuara, por jo në numër të mjaftueshëm siç e kërkon ligji. Ndërsa komunat të cilat nuk e kanë përmbushur obligimin ligjor për punësimin e personave me aftësi të kufizuar, janë 7: Komuna e Vitisë, e Novobërdës, e Parteshit, e Shtimes, e Klllokotit, e Mamushës dhe e Hanit të Elezit.

49. Përveç qasjes fizike dhe asaj në informacione, edhe kompetencat e limituara të stafit të institucioneve arsimore dhe aftësuese për të punuar me fëmijët me aftësi të kufizuara, përbëjnë një nga faktorët kryesor që pengojnë përfshirjen kualitative në arsim të këtyre të fundit. Sipas Down Syndrome Kosova, përfshirja e fëmijëve me sindromën Down në arsimin parauniversitar nuk është në nivelin e duhur. Rrjedhimisht edhe përgatitja profesionale e këtyre të fundit është më e vështirë. Mungesa e përgatitjes profesionale ka ndikim të drejtpërdrejtë në punësim.⁴⁶ Prandaj, në vitin 2019, Down Syndrome Kosova, me mbështetje të GIZ-it, ka hartuar Manualin për Përfshirjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në Qendrat e Aftësimit Profesional (QAP).⁴⁷ Ky manual ofron këshilla konkrete për trajnerët e QAP-it në lidhje me përgatitjen profesionale të këtyre grupeve. Manuali, përpos këshillave praktike, ofron edhe 6 module trajnime të përshtatura për nevojat specifike të personave me aftësi të kufizuara, si në vijim: 1) Kursi i Rrobaqepësisë, i përshtatur për personat me aftësi të kufizuara intelektuale; 2) Kursi për Kamerier, i përshtatur për personat me aftësi të kufizuara intelektuale; 3) Kursi për Kuzhinier, i përshtatur për personat me aftësi të kufizuara intelektuale; 4) Kursi i

⁴⁵ Institucioni i Avokatit të Popullit, Raporti i Avokatit të Popullit, Ex-officio nr.519/2022 në lidhje me punësimin në institucionet qendrore dhe në organet e vetëqeverisjes lokale në Kosovë të personave me aftësi të kufizuara, i qasshëm në: <https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2023/12/Raport-i-Avokatit-t%C3%ab-Popullit-Ex-officio-nr-519-2022.pdf>

⁴⁶ Komunikim me përfaqësuesin e shoqatës Down Syndrome Kosova.

⁴⁷ GIZ, LNOB Social Mapping report Municipality of Hani i Elezit dhe GIZ, LNOB Social Mapping report Municipality of Vitia.

kuzhinierit, i përshtatur për personat me aftësi të kufizuara në të parë; 5) Kursi i Asistentit Administrativ, i përshtatur për personat me aftësi të kufizuara në të dëgjuar; dhe 6) Kursi i Kuzhinierit, i përshtatur për personat me aftësi të kufizuara në të dëgjuar. Sipas vendimit të Ministrisë së atëhershme të Punës dhe Mirëqenies Sociale, ky manual do të duhej të gjente zbatim të menjëhershëm nga Qendrat e Aftësimit Profesional në Kosovë. Megjithatë, ende nuk është realizuar ndonjë monitorim që do ta vlerësonte nivelin e implementimit të këtij manuali në këto institucione.

Qendrat e Arsimit Profesional (QAP), mundësi për t'i përgatitur personat me aftësi të kufizuara për të konkurruar në tregun e punës

50. Në Kosovë veprojnë tetë QAP: Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Ferizaj, Gjiilan, Mitrovicë dhe Mitrovicë Veriore, të cilat shërbejnë për aftësimin dhe riaftësimin e personave të rritur, të cilët janë punëkërkues. Kusht për t'i marrë shërbimet për orientim në karrierë në QAP duhet që punëkërkuesi të paraqitet në qendrën e punësimit.
51. Në këto qendra ofrohen shërbime për 30 profesione nga rreth 70 profesionistë, por nuk ekziston një analizë se sa janë të përshtatshme këto profesione me nevojat e personave me aftësi të kufizuara si dhe me nevojat e tregut të punës.⁴⁸
52. Sipas përfaqësuesve të këtyre qendrave, sfidat qëndrojnë veçanërisht për ofrimin e shërbimeve për personat e verbër, duke qenë se mungon teknologjia asistive. Sipas raportimit të Qendrës së Aftësimit Profesional në Punësim, mungesa e sintezës vokale, literaturës në Braille dhe pajisjeve të veçanta teknologjike e vështirëson ofrimin e shërbimeve për këta persona. Si i vështirë konsiderohet edhe ofrimi i shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara në të dëgjuar. Trajnerët në kuadër të këtyre qendrave nuk kanë njohuri të Gjuhës së Shenjave, çfarë e pamundëson apo e vështirëson komunikimin ndërmjet palëve.
53. Nga ana tjetër, përfaqësuesit e tjerë të QAP-it në Kosovë kanë raportuar për qasje fizike të limituar për personat me aftësi të kufizuara. Shumica e këtyre qendrave raportojnë për ashensorë jofunksional dhe deklarojnë se ofrimi i trajnimeve për përdoruesit e karrocës është i mundur vetëm në katin përdhes. Gjithashtu QAP-i në Prishtinë raporton se edhe tualetet kanë nevojë të përshtaten për nevojat e përdoruesve të karrocës. Pjesa tjetër e infrastrukturës, përfshirë këtu edhe rampat, raportohet të jetë në dispozicion në këto qendra. Asnjëra nga këto qendra nuk ka raportuar të ketë infrastrukturë të përshtatur për personat e verbër, fushë taktile, sinjalistikë në Braille apo grafite prekëse.⁴⁹
54. QAP-të raportojnë se eksperiencia e tyre në ofrimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara intelektuale, me theks të veçantë te personat me sindromën Down, është lehtësuar nga punëtorët socialë të organizatës Down Syndrome Kosova. Punëtorët socialë kanë punuar për së afërmi me trajnerët e qendrave të aftësimit profesional, në kuadër të një projekti të implementuar nga Down Syndrome Kosova dhe mbështetur nga GIZ-i, duke lehtësuar akomodimin e kandidatëve në qendrën e aftësimit profesional. QAP-të menaxhohen nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, përkatësisht nga Departamenti i Aftësimit Profesional.⁵⁰

⁴⁸ Komunikim me përfaqësuesin e DAP/APRK.

⁴⁹ Komunikimi me QAP, 2024.

⁵⁰ Plani Strategjik i Arsimit 2022-2026.

55. Numri i personave me aftësi të kufizuara, të cilët marrin shërbime, është shumë i ulët. Para pandemisë ka pasur iniciativa nga disa organizata për ta përkrahur këtë grup për orientim në karrierë, si: HANDIKOS-i, Sindrom Down, por tani këto iniciativa nuk ekzistojnë më. Sot vetëm 10 persona me aftësi të kufizuara marrin shërbime nga QAP-i, e që është një numër shumë i vogël krahasuar me vitet e kaluara.⁵¹

Punësimi i personave me aftësi të kufizuara

56. Punësimi dhe integrimi në tregun e hapur të punës i personave me aftësi të kufizuara është njëra prej sfidave kryesore për shoqërinë kosovare. Kosova karakterizohet me një shkallë shumë të ulët të punësimit, 29% për popullatën e përgjithshme dhe 55% për të rinjtë. Kjo shkallë është edhe më e ulët kur bëhet fjalë për personat me aftësi të kufizuara. Sipas UNDP-së (2019), 85% e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë janë të papunë. Përjashtimi nga tregu i punës i personave me aftësi të kufizuara nënkupton varësi në skemat sociale të financuara nga shteti, mungesë të pavarësisë ekonomike, pamundësi për integrim dhe pjesëmarrje aktive në shoqëri.

57. Ekzistojnë arsye të ndryshme prapa shkallës së ulët të punësimit të personave me aftësi të kufizuara në Kosovë. Sipas UNDP-së (2019), shumica e bizneseve në vendin tonë nuk kanë eksperiencë në punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Kjo vjen si rezultat i paragjykitimeve ndaj potencialit të personave me aftësi të kufizuara dhe shkathtësive të tyre për punë, por edhe për shkak të pamundësinë për t'i siguruar akomodimet e nevojshme dhe për t'i përshtatur vendet e punës me nevojat e personave me aftësi të kufizuara.⁵²

58. Hulumtimi i Down Syndrome Kosova ka zbuluar një hendek të thellë midis legjislacionit dhe praktikës në lidhje me punësimin e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë. Ky hulumtim, i realizuar në vitet 2017-2018, përfshin një sondazh të një mostre prej 55 entitetesh të zgjedhura në mënyrë të rastësishme nga një listë prej mbi 550 entitetesh, që punësonin mbi 50 persona, nga një spektër i gjerë i sektorëve ekonomikë dhe madhësi të ndryshme të ndërmarrjeve. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se, edhe pse shumica e kompanive janë të vetëdijshme për obligimin ligjor për të punësuar persona me aftësi të kufizuara, vetëm 47% e tyre kanë deklaruar se kanë punësuar të paktën një person me aftësi të kufizuara. Kjo shifër është shumë më e ulët sesa do të pritej, duke pasur parasysh që ligji detyron çdo kompani me mbi 50 punëtorë të punësojë të paktën një person me aftësi të kufizuara. Hulumtimi identifikon disa pengesa kryesore. Së pari, ekziston perceptimi se personat me aftësi të kufizuara nuk janë të aftë t'i kryejnë detyrat e punës në mënyrë efektive. Ky perceptim i gabuar është i përhapur në mesin e punëdhënësve dhe pengon krijimin e një ambienti pune gjithëpërfshirës. Së dyti, mungesa e qasjes fizike në vende të punës është një tjetër pengesë serioze. Shumë vende të punës nuk janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për të lejuar që personat me aftësi të kufizuara të lëvizin lirisht dhe t'i kryejnë detyrat e tyre. Së fundi, mungesa e programeve të trajnimit dhe të mbështetjes për personat me aftësi të kufizuara është një pengesë tjetër. Shumë prej

⁵¹ Komunikimi me QAP, 2024.

⁵² *Sistemi i Informatave në Tregun e Punës*. Baza e të dhënave lidhur me tregun e punës që administrohet nga Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës.

këtyre personave nuk i kanë kualifikimet e nevojshme për të konkurruar në tregun e punës, duke i bërë ata më pak tërheqës për punëdhënësit.⁵³

59. Sipas KDPAK-ut, “*Akomodimi i arsyeshëm në vendin e punës*” - është një term që u referohet “*të gjitha rregullimeve që bëhen në një ambient pune për të lehtësuar pjesëmarrjen dhe performancën e një personi me aftësi të kufizuara*”⁵⁴. Këto rregullime mund të jenë fizike, teknologjike, joteknologjike apo organizative. Sipas Konventës, këto akomodime duhet të jenë të bazuara në një nevojë reale, të lehtësojnë angazhimin e personit në punë dhe të mos përbëjnë një “barrë të papërballueshme” për punëdhënësin. Kjo nënkupton që punëdhënësit duhet të sigurojnë kushte të punës për personat me aftësi të kufizuara bazuar në nevoja individuale, për sa kohë që sigurimi i këtyre akomodimeve dhe i përshtatjeve nuk shkakton për punëdhënësin një barrë të madhe financiare apo të formave të tjera. Arsyeshmëria e një akomodimi kërkon një lloj ekuilibri ndërmjet efektivitetit të atij akomodimi për punëkërkuuesin dhe interesit të punëdhënësit për ta ofruar atë. Kjo e dyta ndikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga benefitet që punëdhënësi percepton nga punësimi i mundshëm i një kandidati. Kultura e ofrimit të akomodimeve për personat me aftësi të kufizuara në Kosovë është e pazhvilluar, ashtu siç edhe praktikata e realizimit të tyre në kontekstin e vendeve të punës janë tejet të limituara.
60. Një arsye tjetër për shkallën e ulët të integritit të personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës ndërlidhet edhe me mospërputhjet mes profileve profesionale ekzistuese të personave me aftësi të kufizuara dhe nevojave të tregut të punës. diskrepanca mes kërkesave të tregut të punës dhe ofertës së fuqisë punëtore është një problem i përgjithshëm në nivel të vendit. Ndryshimet e mëdha teknologjike në botë kanë bërë që kërkesat e tregut të punës, për sa u përket aftësive dhe shkathtësive të punonjësve, të ndryshojnë shpejt. Në anën tjetër, këto ndryshime besohet se nuk janë reflektuar në institucionet arsimore dhe aftësuese që i përgatisin të rinjtë për tregun e punës. kjo diskrepancë është veçanërisht e theksuar kur bëhet fjalë për personat me aftësi të kufizuara në Kosovë dhe e njëjta ndikon në pakësimin e mundësive të këtij komuniteti për integrim në shoqëri.⁵⁵
61. UA nr. 05/2018 përcakton mënyrën dhe procedurat për vlerësimin e aftësisë për punë të personave me aftësi të kufizuara në Kosovë. UA synon të krijoj kushte të barabarta për këta persona, duke e rregulluar procesin e vlerësimit dhe klasifikimit të aftësisë së tyre për punësim, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet ndërkombëtare. Gjithashtu udhëzimi synon të lehtësojë integrimin e personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës, duke u ofruar atyre mbështetjen e nevojshme për të siguruar punësim të qëndrueshëm dhe të denjë⁵⁶.
62. Sipas raportin hulumtues “Qasja e shkollave të nivelit fillor dhe të mesëm të ulët për fëmijët me aftësi të kufizuara në Kosovë”, i realizuar nga HANDIKOS me mbështetje të Zyrës së UNICEF-it në Kosovë, nga vlerësimi i 144 shkollave në shtatë regjione të

⁵³ Down Syndrome Kosova, Punësimi i personave me aftësi të kufizuara, 2020, i qasshëm në: https://downsyndromekosova.org/wp-content/uploads/2023/11/Raporti-_PUNESIMI-I-PERSONAVE-ME-AFTESI-TE-KUFIZUARA.pdf

⁵⁴ KDPAK, neni 27.

⁵⁵ Komunikim me përfaqësuesen e Save the Children.

⁵⁶ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18031>

Kosoves, nga me shumë se 55 mijë nxënës, vetëm 2% e nxënësve janë me aftësi të kufizuara⁵⁷.

63. Një shembull i mirë është Programi për Autonomi dhe Aftësim Profesional, të cilin e zbaton Shoqata Down Sindorm Kosova.⁵⁸ Përmes mentorimit social kanë arritur të punësoheshin 12 persona, të cilët janë përfitues të shoqatës dhe të gjithë vazhdojnë t'i mbajnë pozitat e tyre. Mentorimi social ka arritur të bënte një hartëzim, ku janë identifikuar rreth 80 punëdhënës, të cilët janë të gatshëm të punësojnë dhe të aftësojnë persona me Sindromën Down. Shoqata Down Sindorm Kosova vepron në 4 qendra: Prishtinë, Prizren, Ferizaj dhe Mitrovicë. Mentorët socialë mbështesin punëtorët socialë në këto komuna përmes Programit për Autonomi dhe Aftësim Profesional, por shoqata ndihmon edhe komunat e tjera, si: Hanin e Elezit dhe Kaçanikun, ku janë të identifikuar personat me Sindromën Down, si dhe ku ekziston mundësia e ofrimit të shërbimeve në këto komuna. Mentorimi social edhe në vendet e rajonit është treguar i suksesshëm meqë ka metodologji të detajuar dhe kurrikulë trajnimi. Mentorimi social mund të institucionalizohet dhe të veprojë në institucione të ndryshme, si: në qendra sociale, në agjenci për punësim apo edhe në organizata të ndryshme. Mentorimi social duhet ta ndjekë procesin nga shkollimi deri në punësim për një person të caktuar, e deri te puna me punëdhënësin.

KONSTATIME

64. Ndonëse në përgjithësi, pozita e personave me aftësi të kufizuara është përmirësuar, ata ende përballen në vështirësi serioze dhe janë të ekspozuar ndaj diskriminimit në fusha të caktuara të jetës shoqërore, veçanërisht në fushën e arsimit dhe të punësimit, të shëndetësisë, të qasje në shërbime, në informacione dhe në jetën e komunitetit.
65. Nga rastet që IAP ka pranuar dhe trajtuar përgjatë viteve vëren se problemet kryesore të cilat e vështirësojnë qasjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim vazhdojnë të mbeten probleme zingjirore të ndërlydhura me mungesën e vlerësimit të hershëm të aftësisë së kufizuar, diskriminimin në qasje në institucione parashkollore, mungesën e transportit dhe asistentëve personal si dhe të planeve individuale të mësimi.
66. Avokati i Popullit konstaton se, pas dërgimit të e-mailit drejtuar Drejtorive Komuna të Arsimit në Kosovë me kërkesë për informata lidhur me organizimin e transportit për fëmijët me aftësi të kufizuara për në shkollë dhe anasjelltas, vetëm komunat Klinë, Kaçanik, Obiliq, Lipjan, Gjakovë, Viti dhe Junik kanë kthyer përgjigje, ndërsa 30 komuna⁵⁹ nuk i janë përgjigjur kërkesës për informata. Ky nivel i ulët i përgjigjeve ngre shqetësime serioze lidhur me transparencën dhe përgjegjshmërinë e institucioneve komunale në përmbushjen e detyrimeve të tyre ligjore për garantimin e të drejtave të barabarta në arsim për këtë kategori të ndjeshme të fëmijëve.
67. Nga përgjigjet e marra nga komunat gjithashtu konstatohet se Komuna e Junikut dhe Rahovecit nuk ofrojnë shërbim transporti për nxënësit me aftësi të kufizuara, duke krijuar pengesa serioze për ndjekjen e procesit mësimor dhe duke rrezikuar barazinë në arsim.

⁵⁷<https://handi-kos.org/wp-content/uploads/2004/03/RAPORTI-I-VLERESIMIT-TE-QASSHMERISE-SE-NDERTESAVE-SHKOLLORE-TE-NIVELIT-FILLOR-DHE-MESEM-TE-ULET-PER-FEMIJET-ME-AFTESI-TE-KUFIZUARA-NE-KOSOVE-1.pdf>, <https://handi-kos.org/handikos-publikon-raportin-nga-55-mije-nxenes-ne-144-shkolla-te-kosoves-vec-2-e-tyre-me-aftesi-te-kufizuara/>

⁵⁸ Znj. Luljeta Nuhija, Shoqata Down Sindorm Kosova.

⁵⁹ Komunat: Deçan, Dragash, Drenas, Fushë Kosovë, Ferizaj, Gjiilan, Graçanicë, Hani i Elezit, Istog, Kamenicë, Klllokot, Malishevë, Mamushë, Mitrovicë, Novobërdë, Partesh, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Ranillug, Shtërpçë, Shtime, Skenderaj, Therandë, Vushtrri, Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Zveçan, Leposaviq.

68. Ndryshe nga komunat e lartëpërmendura, komunat Klinë, Obiliq, Lipjan, Gjakovë, Viti dhe Kaçanik kanë ndërmarrë masa për të mbështetur nxënësit me aftësi të kufizuara. Disa prej tyre organizojnë transport të dedikuar, ndërsa të tjerat sigurojnë mbështetje financiare për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit.
69. Profesionistët në institucionet parashkollore, të shkollimit të mesëm të ulët, të lartë dhe profesionale, janë pamjaftueshëm të trajnuar për të punuar me persona me aftësi të kufizuara dhe me lloje të ndryshme të aftësive të kufizuara. Po ashtu mungojnë shërbimet mbështetëse dhe të aftësimit të mësimdhënësve. Personat me aftësi të kufizuara të dukshme (fizike) diskriminohen për shkak të ekzistencës së barrierave fizike për t'u qasur shkollave dhe qendrave profesionale. Për të gjitha kategoritë e ndryshme të aftësive të kufizuara shpesh nuk sigurohen mjetet dhe pajisjet e nevojshme edhe pse ato përcaktohen me legjislacion. IAP sipas përgjigjeve të marra nga Qendrat e Aftësimit Profesional vlerëson se këto qendra përballen me një sërë sfidash infrastrukturore që ndikojnë në efikasitetin dhe mundësinë e përfshirjes së nxënësve me aftësi të kufizuara. QAP-të kanë raportuar për qasje fizike të limituar për personat me aftësi të kufizuara, ku shumica e ashensorëve janë jo funksional dhe se ofrimi i trajnimeve për përdoruesit e karrocës është i mundur vetëm në katin përdhesë. Gjithashtu qendrat nuk kanë raportuar të ketë infrastrukturë të përshtatur për personat e verbër, fushë taktile, sinjalistikë në Braille apo grafitë prekës. Rrjedhimisht, numri i personave me aftësi të kufizuara të cilët marrin shërbime në Qendrat e Aftësimit Profesional është shumë i ultë.
70. Neni 41 i Ligjit për Arsimin Parauniversitar obligon krijimin e ekipeve komunale për vlerësimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në secilën komunë. Përkundër kësaj, 10 komuna ende nuk e kanë krijuar këtë ekip. Shumë prej fëmijëve me aftësi të kufizuara identifikohen në shkollë, e që identifikimi i hershëm dhe ndërhyrja është e vonuar dhe ndikon në zhvillimin e qëndrueshëm të tyre.
71. Ekzistojnë barrierat dhe paragjykimet për punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Siç është konstatuar edhe në Raportin e Avokatit të Popullit, *ex officio* numër 519/2022 në lidhje me punësimin në institucionet qendrore dhe në organet e vetëqeverisjes lokale në Kosovë të personave me aftësi të kufizuara, diskriminimi në punësim është i pranishëm, personat me aftësi të kufizuara me arsim të lartë e kanë të vështirë të gjejnë punë në profesionin e tyre si dhe institucionet qendrore dhe lokale nuk e respektojnë ligjin për punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Sipas këtij raporti, tri ministri nuk e kanë punësuar asnjë person me aftësi të kufizuara duke mos përmbushur obligimet ligjore, pesë ministri kanë punësuar persona me aftësi të kufizuara por jo në numër të mjaftueshëm siç e kërkon ligji.
72. Ngjashëm edhe në sektorin privat, ndonëse nuk ka të dhëna të sakta në dispozicion lidhur e punësimin e personave me aftësi të kufizuara, hulumtimet e organizatave joqeveritare tregojnë se, edhe pse shumë prej kompanive janë të vetëdijshme për obligimin ligjor për të punësuar persona me aftësi të kufizuara, pak prej tyre kanë punësuar të paktën një person me aftësi të kufizuara. Ende ekziston perceptimi i gabuar mes punëdhënësve se personat me aftësi të kufizuara nuk janë të aftë t'i kryejnë detyrat e punës në mënyrë efektive duke penguar në krijimin e një ambienti pune gjithëpërfshirës. Së dyti, mungesa e qasjes fizike në vende të punës është një tjetër pengesë serioze, meqë shumë vende të punës nuk janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për të lejuar që personat me aftësi të kufizuara të lëvizin lirisht dhe t'i kryejnë detyrat e tyre.

73. Avokati i Popullit konsideron se fëmijët me aftësi të kufizuara që nuk marrin trajtimin dhe edukimin e duhur përballen me rreziqe të konsiderueshme duke përfshirë: përjashtimin social meqë mungesa e arsimit mund të çojë në marginalizim të përjetshëm, disavantazh ekonomik meqë pa arsim, mundësitë e punësimit janë shumë të kufizuara si dhe probleme të shëndetit mendor duke qenë se neglizhenca dhe diskriminimi i vazhdueshëm mund të rezultojë në ndikime psikologjike afatgjata. Një shembull i mirë i përkrahjes së personave me aftësi të kufizuara si dhe bizneset në pranimin e tyre është praktika e mentorimit social. Mentorimi social përkrah edhe personat e tjerë në kompani për të kuptuar qasjen dhe bashkëpunimin me personat me aftësi të kufizuara.
74. Siç është konstatuar edhe në Raportin e Avokatit të Popullit, *ex officio* nr. 676/2022-*Arsimimi dhe mundësitë e të rinjve dhe mundësitë e të rinjve në tregun e punës*, arsimi dhe aftësimi profesional nuk është në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Në veçanti, për sa i përket gjithëpërfshirjes së personave me aftësi të kufizuara dhe nevojave të tyre, ka nevojë të bëhet një analizë e mirëfilltë e mundësive të profesioneve për të cilat mungon fuqia punëtore në tregun e punës, të cilat do të ishin të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara.

Avokati i Popullit, bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore.”* Sipas kuptimit të nenit 18, paragrafi 1.2, të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit: *“[...] ka përgjegjësi të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla [...].”*

Prandaj Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit:

1. *Të ndërmarë veprime për rritjen e numrit të asistentëve mbështetës në të gjitha komunat, ashtu që të mundësojë për secilin person pavarësisht aftësive dhe nevojave të veçanta, mundësi të barabarta për t’u arsimuar, siç garanton Kushtetuta e Republikës së Kosovës.*
2. *Të krijojë planprograme të cilat janë të përshtatshme për nxënësit me aftësi të kufizuara, duke përfshirë materialet e ndjeshme për shikim, dëgjim dhe vështirësi motorike.*
3. *Të trajtojë mësimdhënësit/edukatorët që t’i aftësojnë fëmijët në zbatimin e metodave gjithëpërfshirëse.*

Ministrisë së Punës Financave dhe Transfereve:

1. *Të krijojë mekanizma për monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit të standardeve ligjore dhe rekomandimeve për qasje pa vështirësi për institucionet që ofrojnë aftësim profesional për personat me aftësi të kufizuara, sipas Ligji Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e personave me aftësi të kufizuara.*

2. Të krijohen mekanizma të cilët kontrollojnë zbatimin e ligjit për punëdhënësit të cilët kanë më tepër se 50 punëtorë, ashtu që të punësojnë punëtorë me aftësi të kufizuara.
3. Të kryejë një vlerësim të detajuar të infrastrukturës ekzistuese në të gjitha QAP-të, duke identifikuar nevojat për përmirësime fizike për të siguruar qasje të barabartë për personat me aftësi të kufizuara, mungesën e pajisjeve teknologjike dhe burimeve didaktike, kapacitetin e qendrave për të mbështetur numrin në rritje të kandidatëve për aftësim profesional.

Komunës së Deçanit

1. Në rastet kur brenda komunës ka fëmijë me nevoja të veçanta obligohen të sigurojnë transportin apo kompensimin e shpenzimeve për bartjen e sigurtë brenda komunës ose komunës tjetër ku është caktuar të vijoje mësimet fëmija me nevoja të veçanta, siç përcaktohet me Ligjin për Arsimin Parauniversitar Nr. 04/L-032, neni 40 par.4
2. Rregullimi i infrastrukturës në sistemin arsimor dhe QAP-i është i domosdoshëm për t'ua mundësuar qasjen e rregullt të gjithë personave me aftësi të kufizuara. Kjo është një ndër pengesat e para pse ky grup i shoqërisë përfshihet në një numër tejet të vogël në arsim apo zhvillim profesional, prandaj akomodimi i tyre është përcaktuar me Ligjin për Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës e që obligon MASHTI-n dhe DKA-të të sigurojnë "Mjedis mësimor që mundëson qasje, akomodim dhe mbështetje për të gjithë nxënësit."

Komunës së Dragashit

1. Në rastet kur brenda komunës ka fëmijë me nevoja të veçanta obligohen të sigurojnë transportin apo kompensimin e shpenzimeve për bartjen e sigurtë brenda komunës ose komunës tjetër ku është caktuar të vijoje mësimet fëmija me nevoja të veçanta, siç përcaktohet me Ligjin për Arsimin Parauniversitar Nr. 04/L-032, neni 40 par.4
